

SESION SHKENCOR ME RASTIN E 100 VJETORIT TE LICEUT KOMBËTAR NË KORÇË.

Në datën **24 tetor 2017**, në **Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, u organizua sesioni shkencor kushtuar 100 Vjetorit të Liceut Kombëtar në Korçë**. Liceu Kombëtar Shqiptar apo ndryshe Liceu francez, përbën një simbol kulturor për qytetin e Korçës. Si një institucion arsimor, i financuar nga qeveria shqiptare ai kishte synim të përhapë në vend kulturën franceze dhe europiane.

Liceu hapi dyert e tij me 25 tetor 1917, si një lice francez me vendim të qeverisë së Republikës Autonome të Korçës dhe drejtohej nga pedagogu francez Vital Gerson. Më 1921, u riemërua Lice Kombëtar. Të gjitha lëndët me përjashtim të gjuhës shqipe, zhvilloheshin në gjuhën frënge. Kjo shkollë funksionoi nga viti 1917 deri në vitin 1939.

Ky aktivitet ka nisur me fjalën përshëndetëse të Dekanit të FSHNH-së, Prof. dr. Gjergji Pendavinji. Në fjalën e tij, ai veçoi kontributin e filantropit Thoma Turtulli, i cili i dhuroi qytetit të Korçës, liceun këtë vatër dijeje; ashtu si edhe godinën që aktualisht është pjesë e Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, dhe përfaqëson Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane.

Më pas kanë përshëndetur me fjalën e tyre, Zv. Kryetarja e Bashkisë Znj. Benila Themeli dhe përfaqesues të Ambasadës Franceze. Aktiviteti ka vazhduar me kumtesat nga pedagogë të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, dhe përfaqesues të Gjimnazit “Raqi Qirinxhi” të këtij qyteti.



